



REPUBLIKA E SHQIPERISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË IMPAKTIT DHE LIÇENSIMIT

AN190320210018

Tiranë, më: 16.04.2021

Komisioni 17

DEKLARATË MJEDISORE

Në mbështetje të Ligjit Nr. 12/2015 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, VKM Nr. 686, datë 29.7.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësiive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore” dhe me propozim të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Ministri:

VENDOSI :

Lëshimin e Deklaratës Mjedisore për **Zhvilluesin** me të dhënat si më poshtë:

Person Juridik: “Hekurudha Shqiptare”sh.a
Nr. NIPT-i: J61811547D
Adresa e selisë: Lagjja nr.3, Rruga ‘Egnatia’, Durrës
Personi përgjegjës: Ani Dyrmishi

Për të zhvilluar projektin “**Linja Hekurodhore Durrës-Tiranë Terminali Publik i Transportit (Tpt) dhe Linja e Re Hekurodhore për në Aeroportin Rinasit (Tia)**”

Aplikimi është bërë referuar Ligjit Nr. 10440, datë 7.7.2011“Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis” I ndryshuar Shtojca I, 7 a) Ndërtimi i linjave për trafik hekurudhor me distanca të gjata

Vendndodhja: Linja egzistuese hekurudhore Durrës-Tiranë dhe linja e re Durrës-Rinas, Tiranë – Durrës

Gjatësia totale e rrugës: 31170 km

(Bashkangjitur vendimit, gjeni aneksin me hartën topografike dhe koordinatat metrike, ku tregohet vendodhja e objektit)

Bazuar në nenin 12, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, i ndryshuar, i sugjerohet autoritetit planifikues:

Miratimin e lejes/licencës së zhvillimit të atij projekti, me kushtet që duhet të përmbushen ngazhvilluesi, për të parandaluar, minimizuar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis;
Bazuar në pikën 2, të nenit 12, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, të ndryshuar, më poshtë po listojmë:

1. Arsyet dhe konsideratat kryesore, ku është mbështetur mendimi;

- Nuk cënon jetën e banorëve për rreth

2. Mendimi institucioneve të konsultuara:

Drejtoritë teknike të Ministrisë shprehin mendimin si më poshtë: Sugjerojmë që të gjitha mbetjet e gjeneruara gjatë ndërtimit të veprimtarisë të menaxhohen sipas kuadrit ligjor në fuqi në fushën e mbetjeve si më poshtë vijon:

- Ligji nr. 10 463, datë 22.9. 2011”Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar;
 - Të respektohen kërkesat e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 418, datë 25.06.2014 “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim” ;
 - Mbetjet që do të krijohen të specifikohen sipas kodeve të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 99, datë 18.02.2005 “Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve” të ndryshuar;
 - Transferimi i mbetjeve jo të rrezikshme të shoqërohet me plotësimin e shtojcës 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 229, datë 23.04.2014 “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme”, të ndryshuar;
 - Mbetjet e rrezikshme, të dorëzohen sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 371, datë 11.06.2014 “Për përcaktimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe miratimin e dokumentit të dorëzimit të mbetjeve të rrezikshme, të ndryshuar;
 - Subjekti që do të transportojë ose do të transferojë mbetjet të jetë i pajisur me licensë III.2.B , si detyrim i nenit 57, të ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve “ i ndryshuar;
 - Mbetjet inerte të gjeneruara të trajtohen sipas kërkesave të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 575, datë 24. 06. 2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”;
 - Ky projekt pritet të sjellë efekte pozitive në përmirësimin e cilësisë së ajrit duke ulur ndjeshëm sasinë e CO2 që emetohet nga përdorimi i makinave.
- Rekomandojmë që terminali publik i transportit të jetë një ndërtim miqësor me mjedisin, sugjerojmë që ndërtimi të jetë efikas në përdorimin e materialeve lokale dhe të rinovueshme.
- Ndërtimi eko-miqësor do të uli ndikimin negativ në mjedisin tonë dhe burimet tona natyrore. Kjo përfshin transportimin e materialeve nga një distancë e largët, gjë që ka një ndikim negativ në energjinë e kërkuar për t'i transportuar ato, dhe gjithashtu në emetimet e kimikateve të rrezikshme nga një ndërtesë e dizajnuar dobët që i krijon, apo i përthith.
- Sugjerojmë shtimin e hapsirave të gjelbërta rreth zonës ku do të ndërtohet.
 - Duke patur parasysh se ndikimi në ajër i ndotjes akustike për këtë lloj aktiviteti do të jetë i përkohshëm, sugjerojmë të zbatohet legjislacioni specifik në lidhje me zhurmat dhe me nivelet kufi të zhurmave.
 - Rindërtimi dhe ndërtimi i linjës së re hekurudhore do të ketë impakt në habitatet bimore natyrore, kryesisht në habitatet e përbëra nga plepat (P. alba dhe P .nigra). Do të dëmtohen speciet floristike të vendosura kryesisht në skarpatën e linjës hekurudhore, duke qënë se kjo pjesë do të zhvendoset për të ndërtuar linjën e re. Këto specie floristike janë kryesisht barishtore, shkurre mesdhetare të mbira në mënyre natyrore.

- Në raportin e paraqitur nuk është trajtuar si do të kryhet konkretisht procesi i rehabilitimit mjedisor. Nuk janë specifikuar llojet dhe sasia e llojeve bimore drunore, shkurre dhe barishtore që parashikohet të mbillen në zonë.

- Sugjerojmë që të zbatohen me rigorozitet masat e parashtruara në këtë raport VNM-je dhe të kryhen punimet sipas përcaktimeve në të.

- Të shmanget sa më shumë të jetë e mundur dëmtimi dhe prerja e bimësisë së shkurreve, drurëve të gjendura në ekosistemet e brigjeve lumore (Erzeni, Limuth, Lana, Tirana).

- Të merret në konsideratë dhe të përditësohet kuadri ligjor mjedisor dhe institucional në fuqi, për sa i përket pyjeve dhe kullotave në Republikën e Shqipërisë, përkatësisht Ligji Nr. 57/2020, datë 30.04.2020, “Për Pyjet” dhe Ligji nr.9693, datë 19.3.2007, “Për fondin kullor”, i ndryshuar.

- Rekomandojmë që përpara procesit të pastrimit nga bimët, çdo lloj specie e rrallë ose e rrezikuar, duhet të largohet nga zona e ndërtimit. Cdo lloj zhvendosje e specieve në rrezik duhet të diskutohet me autoritetet mjedisore.

- Në raste të prerjes së drurëve si nevojë e projektit të zëvendësohen me prerje fidanësh në krah të linjës hekurudhore.

Pemët e prera të zëvendësohen me te reja të të njëjtit lloj. Të shmanget krijimi i nje korridori bimesh të ndryshme nga bimësia vendase. Përpara se bimët të mbillen të studiohet morfologjia dhe kushte të tjera të zonës në mënyrë që të sigurohet një restaurim dhe mbjellje e efektshme.

- Sipërfaqet e mbjella duhet të mirëmbahen, të shtohen dhe të monitorohen në vazhdimësi nga subjekti, përmes një programi monitorimi periodike.

Të mbillet me filiza bimor vendas e gjithë periferia e territorit të përdorur për shfrytëzim.

Brezi periferik i bimësisë do të ndikojë pozitivisht në cilësinë e ajrit, në uljen e nivelit të zhurmave dhe për më tepër do të rrisë mundësinë për vetëgjenerim të drurëve në pjesën tjetër të zonës.

- Për sa i përket parandalimit dhe zvogëlimit të pasojave në mjedis dhe rehabilitimit të mëvonshëm të tij, sugjerojmë vendosjen e barrierave përgjatë gjithë gjatësisë së hekurudhës me qëllim uljen e numrit të vrasjeve aksidentale të kafshëve;

- Sigurimin e të gjitha paisjeve të nevojshme për riparim, pastrim dhe ndërhyrje në rast emergjencash dhe njoftimin e menjëhershëm të autoriteteve dhe njësive të specializuara;

- Kur është e mundur, nivelet e zhurmës gjatë orëve të agimit, muzgut dhe natës duhet të minimizohen për të zvogëluar shqetësimin, veçanërisht për gjitarët dhe shpendët;

- Me rëndësi të veçantë është rehabilitimi i peizazhit në të gjithë gjurmën e projektit.

- Të minimizohet dëmtimi i sipërfaqëve të panevojshme gjatë ndërtimit;

- Për mbjellje të përdoren lloje vendase, të përshtatura me kushtet e substratit dhe të klimës në zonë si: Gështenjë e egër (*Aesculus hippocastanum*), Dafinë (*Laurus nobilis*), Butinë (*Viburnum tinus*), Boshtër (*Forsythia europaea*), Leandër (*Nerium oleander*), Ilqe (*Quercus ilex*), Rrënjë (*Quercus robur*), Vidh (*Ulmus glabra*, *U. Minor*), Shqopë (*Erica arborea*, *E. multiflora*), Lofatë (*Cercis siliquastrum*), Panjë (*Acer hyrcanum*, *A. pseudoplatanus*, *A. monspessulanum*), Fshikarthë (*Colutea arborescens*), Bli (*Tilia sp.*), etj. Drurëve dhe/ose shkurreve të përdorura për rehabilitimin e mjedisit të dëmtuar duhet t’u sigurohet substrati i duhur i tokës dhe kushtet e mjaftueshme për të mbijetuar.

- Të merren masa për parandalimin e futjes së llojeve të huaja (aliene) invazive. Kështu, përpara fillimit të punimeve, makineritë e rënda që do të përdoren gjatë punimeve duhet të lahen me shumë kujdes (veçanërisht gomat) me qëllim që të zvogëlohet mundësia e shpërndarjes së farave të llojeve bimore invazive. Larja duhet të përsëritet sa herë që makineritë transferohen në një vendndodhje të re. Nëse gjatë punimeve shfaqen lloje invazive, ato duhet të hiqen dhe depozitohen në mënyrën e duhur. Pas aktiviteteve të rehabilitimit, prania e bimëve invazive duhet të monitorohet rregullisht dhe në rast të rishfaqjes duhen zbatuar masa shtesë.

- Për sa i përket fushës së ajrit, rekomandojmë marrjen në konsideratë të masave si më poshtë:

i. Kontrollin e kushteve teknike në mënyrë periodike të mjeteve të punës, për të evituar, parandaluar rrjedhjet e lubrifikanteve dhe hidrokarbureve në mjedis, emetimin e ndotësve të gaztë, të shkaktuara nga avari teknike të mjeteve.

ii. Në rastet kur në mënyrë aksidentale ndodh derdhja e karburantit apo vajit, materiali i derdhur të mblidhet, të pastrohet vendi përkatës, dhe materialet e grumbullura të depozitohen e menaxhohen në mënyrë të sigurtë.

- iii. Monitorimin e cilësisë së ajrit gjatë fazës së punimeve, matjen e pluhurave dhe lëndës së ngurtë pezull.
- iv. Zbatimin e Planit të Monitorimit dhe Menaxhimit Mjedisor gjatë zbatimit të projektit.
- v. Lënda djegëse që do të përdoret nga mjetet e punës, të jetë në përputhje me kërkesat e legjislacionit specifik për cilësinë e lëndëve djegëse.
- vi. Spërkatjen e rregullt me ujë të zonës së punimeve pas çdo procesi pune dhe rrugëve të transportit, për mbajtjen nën kontroll të pluhurformimit dhe ngritjes së tij gjatë transportit të materialeve të ndërtimit.
- vii. Gjatë transportit, mjetet transportuese mos të ngarkohen më shumë se kapaciteti I projektuar dhe të mbulohen me mbulesa, për të parandaluar rrjedhjet në rrugë dhe emetimin e pluhurave.
- viii. Vendosja e sinjalistikës për punimet në zonën e projektit. Marrja e masave për menaxhimin dhe shmangien e trafikut, që do të krijohet për shkak të makinerive dhe automjeteve transportuese, menaxhimin në kohë të tij.
- ix. Kontrollin dhe mbajtjen e ndikimeve mundësisht brenda zonës së punimeve.
- Të zbatohen të gjitha masat e planifikuara në këtë raport për rehabilitimin e mjedisit të prekur nga zhvillimi i këtij aktiviteti në mënyrë kthimin sa më afër gjendjes fillestare.
 - Të hartohet dhe zbatohet një plan emergjence parapërgatitore në mënyrë që të përballlet me rrjedhjet aksidentale të kimikateve, hidrokarbureve, vajrave.
 - Tanket e hidrokarbureve dhe zonat përreth tyre duhet të menaxhohen në përputhje me kërkesat dhe legjislacionin në fuqi, për mbrotjen e mjedisit dhe atij për Naftën dhe produktet e naftës.
 - Të merren masat për parandalimin e shkarkimeve të kimikateve dhe hidrokarbureve, në burimet ujore .
 - Lidhur me kimikatet e rrezikshme që do të përdoren gjatë ndërtimit, sugjerojmë si më poshtë:
 - a) Kimikatet të jenë në përputhje edhe me kërkesat e Ligjit 27/2016 “Për menaxhimin e kimikateve” dhe aktet e dala në zbatim të tij.
 - b) Kimikatet të ruhen, magazinohen, dhe të menaxhohen në përputhje me kërkesat e legjislacionit kombëtar në fuqi për kimikatet.
 - c) Kimikatet të jenë të klasifikuara, etiketuara dhe paketuara në përputhje me VKM nr. 488, date 29.06.2016)
 - d) Dokumenti shoqëruar me të dhenat për sigurinë kimike (MSDS), duhet të jetë në gjuhën shqipe dhe të përdoret versioni më i fundit në dispozicion.
 - e) Në varësi të kimikateve të rrezikshme që do të përdoren, dhe origjinës së tyre (import ose jo), të verifikohet dhe sigurohet nëse duhen ndjekur Procedurat specifike mbi Njoftimin e Eksportit në vendin tonë, sipas legjislacionit në fuqi (VKM nr. 665, date 21.09.2016).
 - Lidhur me bazën ligjore, sugjerojmë marrjen në konsideratë dhe citimin në raport edhe të Ligjit nr. 27/2016 “Për menaxhimin e kimikateve”, dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.
- Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura shprehet: Projekti nuk prek në Zona të Mbrojtura.*
- Agjencia Rajonale e Mjedisit: Shprehet parimisht dakort për zhvillimin e aktivitetit.*

Bashkia Durrës shprehet: parimisht dakort për zhvillimin e aktivitetit

- **Informacion për procesin e realizuar të konsultimit me publikun:**

Konsultimi me publikun: Morën pjesë përfaqësues nga komunitetet e zonave, përfaqësues nga Pushtetet Vendore si dhe nga Drejtoria Rajonale e Mjedisit dhe përfaqësues nga studio mjedisore. Nuk pati ndonjë shqetësim nga komuniteti për zhvillimin e këtij aktiviteti. Në takim është prezantuar projekti, janë dëgjuar sugjerimet e pjesëmarrësve, të cilat do të merren parasysh nga ana e investitorëve, gjatë kohës së shfrytëzimit. Nga ana e investitoreve iu sigurova të pranishmeve që do të merren të gjitha masat për eliminimin e ndikimeve negative në mjedis, duke mos cënuar jetën e banorëve.

3. Përshkrimin, sipas rastit, të masave kryesore që duhen marrë për të shmangur, reduktuar e nëse është e mundur, për të korrigjuar efektet negative të rëndësishme:

- 3.1 Ky vendim është I vlefshëm, nëse ndërtimi I objektit është në përputhje të plotë me Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Planin e Detajuar Vendor, të miratuar nga organet kompetente (KKT / Bashkia / Njësi Administrative) dhe akteve ligjore në fuqi.
- 3.2 Në rast se gjatë punimeve shfaqen elemente të tilla si: objekte kulturi, gjurmë arkeologjike, burime ujore etj, subjekti të ndërpresë punimet dhe të lajmërojë urgjentisht organet kompetente.
- 3.3 Ky Vendim është I vlefshëm pasi subjekti të ketë marrë miratim nga institucionet kompetente.
- 3.4 Subjekti duhet të tregoj kujdes të veçantë për menaxhimin e mbetjeve inerte duke mos I hedhur ato në mjedise ujore.
- 3.5 Të kryhen punimeve në gjurmët e projektit të propozuar.
- 3.6 Masa e dheut e gjeneruar nga operacionet e gjurmimit, të sistemohet në një vend të caktuar dhe të ruhet për qëllimin e rehabilitimit.
- 3.7 Të merren masa për të parandaluar rëniet e zjarrit gjatë realizimit të punimeve në terren dhe të sigurohen mjetet e nevojshme të ndërhyrjes në rast të rënies së zjarrit (zjarrfikse të lëvizshme, bombula me shkumë, etj);
- 3.8 Për asnjë arsye mos të ketë prerje pemësh në zonën ku do të zhvillohet projekti.
- 3.9 Niveli i zhurmave gjatë procesit të jetë brenda normave të lejuara dhe të punohet në orare kur shqetësimi I banorëve dhe zonave përreth të jetë me ndikim sa më të ulët.
- 3.10 Të bëhet rrethimi I zones ku do të realizohen punimet, për të shmangur hyrjet e paautorizuara.
- 3.11 Gjatë fazes së rikonstruksionit të mbahet nën kontroll ndotja e ajrit, Brenda standarteve të OBSH-së;
- 3.12 Subjekti të kujdeset për menaxhimin e mbetjeve të krijuara nga veprimtaria, sidomos ato të ambalazhimit, duke I transportuar në mënyrë të rregullt në vend grumbullimit e caktura nga njësi vendore. Zotëruesit e mbetjeve inerte duhet të zbatojnë detyrimet që janë të përcaktuara në VKM nr.575, datë 24.06.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte"
- 3.13 Për asnjë arsye mos të ketë hedhje të mbetjeve inerte pranë burimeve ujore.
- 3.14 Vendosja e ndriçimit gjatë rrugës të bëhet në bashkëpunim me organet kompetente të energjisë elektrike.
- 3.15 Subjekti të realizojë në mënyrë të menjëhershme çdo ndërhyrje teknike për të riparuar çdo fenomen negativ në mjedis si pasojë e veprimtarisë së tij.
- 3.16 Kompania të ndjek me përpikmëri projektin teknik për të evituar erozionin e tokës, me qëllim ruajtjen e cilësisë së ujrave sipërfaqësore dhe nëntokësore.
- 3.17 Të vendoset sinjalistika paralajmëruese përgjatë gjithë segmentit të punimeve me qëllim shmangien e aksidenteve njerëzore.
- 3.18 Në raste aksidentesh ose defektesh që shkaktojnë ndotje të mjedisit, subjekti menjëherë duhet të jap informacion në ARM-në e qarkut përkatës dhe AKM, të cilat bëjnë të mundur njoftimin e populates që preket nga ky aksident.
- 3.19 Para fillimit të veprimtarisë të trajnohen të gjithëpunëtorët e subjektit si dhe të njihen me termat dhe kushtet e sipërcituara në Vendim.
- 3.20 Kompania duhet të respektojë gjithashtu edhe kushtet e vendosura në raportin e VNM-së që është paraqitur në aplikim si dhe të ketë parasysh Ligjin Nr. 10 431, datë 9.6.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit".

3.21 Monitorimi dhe Raportimi

Në bazë të Ligjit Nr. 128/2020 Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 10440, datë: 07.07.2011, "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", të ndryshuar, Neni 25/1 "Monitorimi dhe vlefshmëria", zhvilluesi ka detyrimet si më poshtë:

- **Zhurma dhe Vibracionet**

- Të zbatohen nivelet kufi të zhurmës, referuar Udhëzimit Nr. 8, date 27.11.2007 “Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara” dhe Ligjit Nr.9774 date 12.07.2007 “Për vleresimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”
- Të merren masa për mbrojtjen e punonjësve nga zhurmat.
- Të merren masat për kufizimin e orareve të punës në kantier.
- Operatori duhet të parandalojë gjenerimin e zhurmës impulsive në zonat e ndjeshme ndaj zhurmës, gjatë operimit të instalimeve.
- Vibrimet në vende të ndjeshme nuk duhet të kalojnë 10 mm/s (PPV) në çdo kohë.
- Të bëhet monitorimi i zhurmave për mjediset: automjete/kamiona në hyrje të kantierit, kantier ndërtimi dhe mjedisi urban më i afert me kantierin çdo 6 muaj.

Tabela e niveleve kufi:

Mjedisi	Vlera kufi e zhurmës dB(A) Leq, T Ditë	Vlera kufi e zhurmës dB(A) Leq, T Mbrëmje	Raportimi në AKM	Periodiciteti
Automjete/kamiona ne hyrje te kantierit	55	45	18.10.2021	Çdo 6 muaj
Kantier ndertimi	55	45	18.10.2021	Çdo 6 muaj
Mjedisi urban me i afert me kantierin	55	45	18.10.2021	Çdo 6 muaj

- Shkarkimet në Ajër

- Të zbatohen nivelet kufi të shkarkimeve në ajër, referuar Ligjit Nr. 162/2014 “Për Mbrojtjen e Cilësisë së Ajrit në Mjedis” dhe VKM Nr. 248, datë: 24.03.2003 “Për Miratimin e Normave të Përkohshme të Shkarkimeve në Ajër dhe Zbatimin e tyre”.
- Shkarkimet në ajër të jene brenda normave të lejuara, duke marre masa për reduktimin e tyre.
- Kantieri në të cilin emetohen lëndë grimcore në ajër, duhet të pajiset sipas mundësive teknike dhe mbi bazën e natyrës së procesit, me rrjeta uji / sisteme spërkatje / sisteme heqje pluhurash.
- Të bëhet monitorimi i nivelit të pluhurave në ajër, për mjediset: kantier ndërtimi dhe mjedisi urban më i afert me kantierin çdo 6 muaj.

Tabela e niveleve kufi

Ndotësi	Përqëndrimi	Raportimi në AKM	Periodiciteti
Lënda grimcore (PM _{2.5})	20-25 µg/m ³	18.10.2021	Çdo 6 muaj
PM ₁₀	50 µg/m ³ 40 µg/m ³	18.10.2021	Çdo 6 muaj

- Subjekti duhet të sjellë pranë AKM-së si më poshtë:

- Informacion në momentin e fillimit të punimeve
- Raportimin periodik për parametrat që do të monitorohen sipas datës së raportimit / çdo 6 muaj.
- Informacion në përfundim të punimeve, lidhur me punimet rehabilituese të territorit përreth, shoqëruar edhe me foto.
- **Afati i Vlefshmërisë**
- Vendimi për VNM-në paraprake për projektin e propozuar është e vlefshme për aq kohë sa është i vlefshëm edhe dokumenti i miratimit të zhvillimit për projektin.

- Nëse projekti, që i është nënshtruar procesit të VNM-së, nuk fillon zbatimin në terren brenda 2 vjetëve nga data e miratimit të deklaratës mjedisore apo të vendimit për VNM-në paraprahe, atëherë këto dokumente konsiderohen të pavlefshme dhe procesi i VNM-së fillon nga e para.

Në bazë të udhëzimit të MM dhe MF nr. 7938, datë 17.7.2014 “Për përcaktimin e tarifave dhe vlerave përkatëse për shërbimet që kryen Ministria e Mjedisit për procesin e VNM-së”, ky subjekt ka kryer pagesën 50.000 lekë.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM I AKM

EDISON KONOMI


MINISTRI

BLENDI KLOSI

Konceptoi:

Miratoi:

Aneksi 1. Planvendosja e sipërfaqes së objektit



Pika	X Gauss Kruger	Y Gauss Kruger
1	4370744.65	4577175.84
2	4371946.48	4577022.75
3	4371113.32	4576444.30
4	4373689.24	4576859.88
5	4374258.68	4577838.88
6	4375044.87	4578978.76
7	4376373.36	4580298.58
8	4377518.42	4581553.23
9	4378183.57	4582599.44
10	4379428.51	4582919.09
11	4381265.38	4583000.43
12	4382924.69	4583044.86
13	4384554.34	4583418.90
14	4385594.07	4585086.65
15	4386473.37	4585982.63
16	4387531.71	4585871.63
17	4388322.49	4585037.04
18	4389121.34	4583845.69
19	4389659.94	4583011.11
20	4391038.8	4582759
21	4391944.7	4582776
22	4392109.4	4582960
23	4392144.3	4583260
24	4392235.28	4584282.95
25	4392465.43	4586242.66
26	4392518.58	4587981.50
27	4392202.5	4582932
28	4392410.7642	4582801.173
29	4392974.53	4582182.52
30	4393655.03	4581738.36
31	4394422.21	4581387.86
32	4395770.86	4580986.85
33	4396829.45	4580671.27
34	4397687.96	4580082.25